

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit ¹	73350-24-1376-1-3-6
Nr i brendshëm	QKMF-24-003-1-3-6

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me paisje elektrike për QKMF-në dhe njësitë e saj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044/974-590

(Numri Telefonit)

10.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Astrit Uka- menaxher

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë)

Infinitt.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

07.05.2024..

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 26.02.2023.
Njoftimi per dhenie te kontrates /
Njoftimi mbi vendimin e AK: 14.03.2024.
Afati i fundit per dorzimin e ofertav 05.03.2024. ora 12:30
Data dhe ora e fillimit të hapjes së ofertav 05.03.2024. ora 12:30
Njoftim për shfuqizim të vendim të dates 14.03.2024 eshte nxjere me 05.04.2024.
Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 24.04.2024.
Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

Letren standarde per tenderuesin e pasuksesshem se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 24.04.2024.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraparak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 26.04.2024.

Njoftimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 26.04.2024.

Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 30.04.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qëllimi

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 10 i UDHEZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtetat që kanë domethënie si në vijim:

AK- Autoritet Kontraktues

OE- Operator Ekonomik

LPP- Ligji i prokurimit publik

AK/Zyra e prokurimit gjatë vleresimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe rregulloren për prokurim publik.

AK/ QKMF Prishtine me 24.04. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e AK ku ka rekomanduar për kontratë OE EOR GROUP SH.P.K.

Pas pranimit të vendimit të AK me 25.04. kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe qasja na është aprovuar/lejuar nga AK po me 25.04.

Nga dokumentet të cilat i kemi pranuar në qasjen në dokumente zyrtare konstatojmë se AK ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm oferta e të cilit nuk plotëson specifikimet teknike të parashtruara nga AK si në ANEKS 1 të dosjes së tenderit.

OE Eor group nuk plotëson specifikimet teknike për pozicionin 3 në paramasë. Është kërkuar frigorifer 145litra ndërsa modeli Ecolux MFR 140 ka kapacitet 95litra, kete mund të verifikoni në web-faqen e distributorit të ecolux për Kosovë shih linkun: <https://interplast-group.com/product/frigorifer-ecolux-mfr-140/> apo nepermjet emailit duke ju drejtuar kompanisë në fjalë.

OE Eor – Group ka manipuluar katalogun e produkteve duke paraqitur shënime jo-reale në kete menyre është vënë në lajthitje komisioni vlerësues pranë AK duke i marrë si të mirëqena/reale shënimet e vendosura në katalog nga OE. Në rastet të tilla AK duhet të drejtohet Organit shqyrtues të prokurimit konform nenit 99.2 të LPP-se të kërkojë diskualifikimi i OE të cilit dorëzojnë dokumente të rrejshme/mashtruese në ofertim.

OE në fjalë poashtu është i papërgjegjshëm pasi që në bazë të katalogut të dorëzuar për pozicionin 10 nuk ka ofruar kabllo 5metra por 3metra gjatësi.

AK/komisioni vlerësues favorizon haptas OE në fjalë duke i kërkuar sqarime shtesë lidhur me pozicionet 3, 10 në paramasë megjithatë katalogu i paraqitur për keto dy pozicione nga OE nuk plotëson specifikimet teknike minimale për pozicionet 3, 10 në paramasë.

Sipas dokumenteve te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare shihet se AK i drejtohet OE Eor Group sh.p.k. me kerkese per sqarime shtese per pozicionet 3, 10 ne paramase.

OE deklarohet se per pozicionin 3 nuk eshte kerkuar tek pershkrimi ne kolonen 3 qe frigoriferi te kete minimum 145litra. Ky konstatim i OE eshte i palogjikshem kur shihet se ne kolonen e dyte eshte kerkuar frigorifer 145litra dhe OE obligohet ti permbahet specifikimit teknik per pozicionin ne fjale. Citoj kerkesen e AK ne ANEKS 1: Mallrat duhet të jenë të ngjashme me specifikat si më poshtë, faqe 10 dhe 11. Kuptohet qe pershkrimi ne kolonen 2 dhe 3 paralelisht kane te beje me te njejtin produkt pasi qe nuk mund te kerkohen produkte te ndryshme brenda nje rreshti.

E njejta qeshtje vlen dhe per pozicionin 10 Kabllo vazhduese.

Ne baze te nenit 10 te UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK ne rastet kur eshtë dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik

për mallrat e ofruara Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ neni 69.

Anomalia me e madhe ne kete rast eshte se OE edhe pas kerkeses per sqarime shtese ku AK i mundeson te sqarohet per frigorifer ne pozicionin 3 nuk tenton te permiresoje gabimet duke ndryshuar eventualisht produktin e ofruar por vazhdon te sqarohet se nuk kane qene kerkese te pershkrimi i produktit qe frigoriferi duhet te kete 145litra ne kete menyre vazhdon te kerkoje qe AK ti pranoje si te mireqene frigoriferin me 50litra me pak se kerkesa minimale ne ANEKS 1 te DT. Kerkesa per litra ka qene e pershkruar tek emertimi i produktit dhe si e tille eshte dashur te respektohet nga OE ofertues pasi qe edhe kompania jone sikur te lejohej te ofronte frigorifer 95litra per kete pozicion do te mund te ofertonim me cmim me te ulet ne kete menyre do te ndryshonte dhe renditja e ofertuesve me cmim me te ulet.

Ky trajtim nga AK per OE ne fjale bie ndesh me Nenin 38 te rregullores per prokurim publik- Sqarimi i Tenderëve perkatesisht 38.2 dhe 38.3, citoj:

38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

Konform pikes 38.2 te rregullores per prokurim publik nuk lejohet ndryshim i ofertes, ne kete rast katalogut te dorezuar nga OE ndersa konform pikes 38.3 lejohet te ofrohen informacione shtese apo dokumente te cilat mungojne ne tender e jo te ndryshohen/modifikohen ato te cilat jane dorezuar.

Asnje dispozite ligjore nuk parasheh qe te veprohet si ne kete rast te ndryshohet katalogu apo te kerkohet sqarime shtese ne rast se katalogu i dorezuar nuk ploteson specifikimet teknike minimale te parashtuara ne DT.

Zyra e prokurimit ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim ne paragrafin 1 ka cekur se OE i rekomanduar per kontrate ploteson kriterin nr 1 lidhur me kapacitetin teknik&profesional pasi qe ka dorezuar listen e kontratav dhe referencat, theksoj faktin se nuk ka qene fare pretendim ankimor i kompanise sone se OE ne fjale nuk posedon deshmita/ referencat.

Lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar per kontrate ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim AK thekson se ne baze te verifikimeve komisioni ka konstatuar se nuk ekziston frigorifer 145litra dhe vendosin te pranojne si te mireqene frigoriferin

95litra te ofertuar nga OE i rekomanduar per kontrate pasiqe ploteson nevojat e institucionit.

Nese AK ka kerkuar frigorifer 95litra eshte dashur te ceket tek specifikimet teknike per pozicionin ne fjale ne te kunderten ne kete faze nuk lejohet te behet vleresimi i ofertav jasht specifikimeve teknike dhe kriteret te parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit kjo dhe duke u bazuar ne dispozitat ligjore 52.3/56.3/59.4 te LPP-se. Pikerisht per faktin se nuk kemi arritur te sigurojme frigorifer me kapacitet 95litra ne kemi ofertuar modelin Ecolux – VECO234N i cili ka 166litra duke tejkalluar kapacitetin minimal prej 145litrav te kerkuar ne dosjen e tenderit, autoriteti kontraktues ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim mundohet te kontestojte modelin e frigoriferit te ofertuar nga kompania jone duke aluduar se ka mosperputhje mes specifikimeve teknike dhe fotos se paraqitur ne katalog mirepo ky konstatim i AK nuk qendron dhe nuk eshte pretendim ankimor dhe per faktin se nuk eshte cekur si arsyeje ne leter standarde drejtuar kompanise sone.

Zyra e prokurimit gjate zhvillimit te kesaj procedure ka shkelur dhe nenin 30.4 te rregullores per prokurim publik duke kerkuar vazhdimin e vleshmerise se ofertes vetem per 20dite shtese nga data 16.04. deri me 06.05. dhe ne kete menyre ofertav iu ka skaduar validiteti me 06.05. Kompania jone ka bere vazhdimin e vlefshmerise per 45dite prej dates se skadimit.

Mare parasysh faktet e lartecakura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem oferta e te cilit nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionet 3, 10 ne paramase, prandaj kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim, ri-vleresimi i ofertav nga AK te behet ne harmoni me kerkesat per specifikimet teknike te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK/zyra e prokurimit ka ardhe deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem ne kete menyre eshte favozuar OE ne fjale dhe nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartecakura. Kompanise sone si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet i eshte mohuar fitimi i nje kontrate publike dhe fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe faktev te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.